# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-465710**
VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Top News – Raketa balistike mbi maternitet / Sulmet ruse vrasin tetë persona në Ukrainë - Top Channel |
| ADRESA | `https://top-channel.tv/video/top-news-raketa-balistike-mbi-maternitet-sulmet-ruse-vrasin-tete-persona-ne-ukraine/` |
| BURIMI | top-channel.tv |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 24 shtator 2026, 11:20:57 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| KOHA E PORTALIT | nuk jepet<br>*Ky portal nuk e deklaron datën dhe nuk e shkruan as të dukshme. Mbetet vetëm ora jonë e kapjes.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `370a560803265b323f52367202bd6924a08cf97a2c25ffca577f549f1138c250` |
| TEKSTI | `a994a51037babed7669cb8aa75c3c1915f6dc066f2aa86a095ae92ab48ae5292` |
| PAMJA | `06178e33c93ea65e6ffe61608de3ab70caf3d978957f24d5f961a0eb98a59a0f` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `62c1d3a38d30b40cedc28651d655c005ea8a95e70a2bd892d990ffa3970faffd` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `d2ca4088eb50e1b4ccc2aac7982103f0051462d31f94452db6e22b0091e548dc` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/62c1d3a38d30b40cedc28651d655c005ea8a95e70a2bd892d990ffa3970faffd`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

## VIDEO

# Top News – Raketa balistike mbi maternitet / Sulmet ruse vrasin tetë persona në Ukrainë

24/09/2026 13:19

Sulmet ruse me dronë dhe raketa ndaj kryeqytetit të Ukrainës, Kievit, dhe zonave verilindore vranë tetë persona të enjten dhe në mesin e objektivave të goditura ishin një maternitet dhe një fermë, njoftuan zyrtarët. Moska e ka intensifikuar luftën ajrore muajt e fundit, duke përdorur më shumë dronë të shpejtë dhe të vështirë për t'u ndalur, ndërkohë që Ukrainës i mungojnë raketat përgjuese për të rrëzuar raketat balistike. Dy persona humbën jetën në sulmin e fundit ndaj Kievit, sipas Presidentit Volodymyr Zelensky, i cili ndodhet në Nju Jork për Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së. "Ndërsa njerëzit flinin, shpërthimet ndriçibub qiellin," tha Zelensky në Telegram. "Edhe një herë, objektivat kryesore të sulmit të tyre ishin Kievi dhe infrastruktura civile: ndërtesa banimi, një maternitet, infrastruktura energjetike dhe logjistika". Në Kiev, përveç dy viktimave, u plagosën edhe tetë persona; njëri prej të plagosurve ndodhej në parkingun e maternitetit, tha kryetari i bashkisë, Vitali Klitschko. Zyrtarët thanë se u dëmtuan një pjesë e fasadës, dritaret dhe dyert e spitalit, por shtuan se nuk pati pacientë apo personel mjekësor të lënduar. Policia njoftoi se në Kiev u dëmtuan gjithashtu nëntë shtëpi, një zyrë postare, magazina dhe dhjetëra automjete. Një sulm i veçantë rus ndaj një objekti për ruajtjen e perimeve në një fermë në një fshat të rajonit verilindor të Kharkiv-it vrau gjashtë persona dhe plagosi 12 të tjerë, thanë prokurorët. Breshëria e sulmeve gjatë natës në mbarë Ukrainën përfshiu një numër të paspecifikuar raketash hipersonike dhe balistike, 282 dronë dhe armë të tjera, njoftoi Forca Ajrore e Ukrainës. Autoritetet në rajonin veriperëndimor të Rivne-s njoftuan për dëme në infrastrukturë nga sulmet e natës që vazhduan deri në mëngjesin e së enjtes, pa dhënë detaje të mëtejshme. Nën sulm u gjend edhe rajoni i Volyn-it, që kufizohet me Poloninë. Presidentja e Moldavisë, Maia Sandu, tha se katër dronë rusë hynë në hapësirën ajrore të vendit dhe




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.